

## MBRONI FËMIJËN TUAJ

Vaksina do ta mbrojë fëmijën tuaj kundër gripit dhe komplikimeve serioze si bronkiti dhe pneumonia.



## MË MIRË SE SA TA FITOJ GRIPIN!

## MBRONI VETEN, FAMILJEN DHE MIQTË TUAJ

Me vaksinimin e fëmijës tuaj do të mbroni edhe gjyshërit, anëtarët e familjes dhe miqtë që nuk mund të vaksinohen.

## PSE DUHET TË VAKSINOHET FËMIJA ÇDO VIT?

Viruset e gripit po ndryshojnë vazhdimisht dhe nuk është e pazakontë që çdo vit të shfaqet një lloj i ri i virusit të gripit. Vaksinimi para çdo sezoni është mënyra e vetme dhe më e sigurtë e parandalimit të gripit.

## E RËNDËSISHME!

Fëmijët nga 6 muaj deri në 5 vjeç, si dhe fëmijët mbi 6 muajsh me sëmundje kronike mund të vaksinohen falas kundër gripit!

Fëmijët nën 9 vjeç, nëse vaksinohen për herë të parë, rekomandohet që të marrin dy doza me një interval prej 4 javësh dhe më pas të vazhdojnë të vaksinohen një herë në vit.

## CAKTONI VAKSINIMIN PËRMES UEB PRATFORMËS!

Terminet për vaksina falas bëhen përmes ueb-faqes:

[www.vakcinacija.mk](http://www.vakcinacija.mk)

Duke plotësuar formularin, ju regjistroheni për vaksinim direkt në sistemin e Moj Termin. Me anë të një mesazhi SMS, do të merrni informacion për datën dhe orën e saktë të vaksinimit në pikën që zgjidhni gjatë regjistrimit.

Përveç kësaj, ju mund të merrni një vaksinë komerciale kundër gripit në qendrën tuaj më të afërt të Shëndetit Publik pa një paraqitje paraprake.

# Çfarë dini për gripin?

# Si ta mbroni më mirë fëmijën tuaj?

# VAKSINOJENI ATË!



## PSE FËMIJA IM DUHET TË VAKSINOHET KUNDËR GRIPIT?



Gripi është një sëmundje që shkaktohet nga virusi i gripit (influenza) që prek traktin e sipërm respirator (hundën dhe fytin), ndërsa në forma më të rënda edhe traktin e poshtëm të frymëmarrjes (bronket). Gripi mund të jetë një sëmundje shumë e pakëndshme për fëmijët, duke shkaktuar temperaturë, lodhje, dhimbje muskujsh dhe nyjesh, hundë të zënë, kollë të thatë dhe dhimbje të fytit. Fëmijët fillojnë të ndjehen më mirë pas një jave. Disa fëmijë mund të kenë nevojë të shtrihen në spital.

## ÇKA JANË PËRFITIMET E VAKSINËS?

Fëmijët nën moshën 5 vjeç janë më të nënshtuar ndaj hospitalizimeve për shkak të gripit!

Gjithashtu vakcina zvogëlon mundësinë që anëtarët e tjerë në familjen tuaj të sëmuren, siç janë gjyshërit ose ata me sëmundje kronike.

Mund t'ju ndihmojë të shmangni marrjen e pushimit mjekësor nga puna ose aktivitete të tjera për t'u kujdesur për fëmijën tuaj ose nëse ju vetë sëmureni nga gripi.

## SI TRANSMETOHET GRIPIT?

Gripi është një sëmundje ngjitëse që përhapet drejtpërdrejt nga personi në person, kryesisht nëpërmjet grimcave të imëta që personi i infektuar hedh gjatë kollitjes dhe teshtitjes, ose indirekt nëpërmjet kontaktit me sipërfaqet përreth që ka prekur ose objektet që ka përdorur.

Simptomat e sëmundjes shfaqen 1 deri në 4 ditë pasi që virusi ka hyrë në trup. Shumica e njerëzve mund ta transmetojnë virusin tek të tjerët, një ditë para shfaqjes së simptomave dhe 5-7 ditë pas shfaqjes së sëmundjes. Kjo do të thotë që një person mund të transmetojë virusin përpara se të kuptojë se është i infektuar.



## A MUND TË JEPET VAKSINA KUNDËR GRIPIT NË TË NJËTËN KOHË ME VAKSINA TË TJERA?

PO. Fëmija juaj mund të marrë vaksinën e gripit së bashku me vaksinat e tjera nga kalendari i vaksinimit.

## A KA EFEKTE ANËSORE NGA VAKSINA E GRIPIT?

Efektet anësore të vaksinave kundër gripit janë të lehta në krahasim me pasojat potencialisht serioze të infektimit me virusin e gripit.

Efekti anësor më i zakonshëm është reaksion lokal në vendin e aplikimit në formën e dhimbjes, ndjeshmërisë, skuqjes dhe/ose ënjtjes. Mund të shfaqet dhimbje koke, lodhje, djersitje, humbje oreksi, irritim, dhimbje stomaku ose barkqitje, por të njëjtat janë afatshkurtra dhe kalojnë brenda 24 deri në 48 orëve.

**Vaksinimi është  
mënyra më efektive  
për të parandaluar  
komplikimet  
nga gripi.**